



Qeveria e Republikës së Maqedonisë

Agjensioni për përkrahje finansiare në bujqësi dhe zhvillim rural

Në bazë të nenit 9 paragrafi 1 nga Ligji për ratifikimin e Marëveshjes sektoriale mes Qeverisë së Republikës së Maqedonisë dhe Komisionit të Unionit Europian për vendosjen e dispozitave për menaxhimin dhe zbatimin e ndihmes finansiare të Unionit për Republikën e Maqedonisë sipas Instrumentit për ndihme në sektorin e politikës për “Bujqësi dhe zhvillimin rural” (IPARD) (Gazeta zyrtare e RM nr.38/2016), në bazë të pjesës II mase të investimeve në mjete finansiare të bujqësis pika 11, mase të investimeve në mjete materiale për përpunimin e prodhimeve bujqësore dhe produktet e peshkut pika 11, masa në Diversifikimin e fermave dhe zhvillimin e biznesit pika 11 nga Programi për përdorimin e mjeteve nga Instrumenti për ndihme për zhvillimin rural në Unionin Europian (IPARD) për periudhën 2014-2020 (Gazeta zyrtare e RM nr.177/2016), dhe në bazë të nenit 6 nga dekreti për mënyrën dhe procedurën e shfrytëzimit të mbështetjes finansiare për masat për zhvillimin rural të finansuara nga IPARD 2014-2020 (Gazeta zyrtare e RM nr.64/2016)

Agjensioni për përkrahje finansiare në bujqësi dhe zhvillim rural

më 24 prill të vitit 2017 shpall

THIRRJE PUBLIKE nr. 01/2017

për dorëzimin e kërkesave për shfrytëzimin e mjeteve

nga Programi IPARD 2014-2020

1. Agjensioni për përkrahje finansiare në bujqësi dhe zhvillim rural (në tekstin e mëtejshëm: Agjensioni) si institucion kompetent dhe organ kontraktues për zbatimin e Instrumentit për ndihmë para-hyrëse për bujqësi dhe zhvillim rural të Unionit Europian (IPARD) ju bën thirrje të gjithë personave fizik dhe juridik nga Republika e Maqedonisë të dorëzojnë kërkesa për shfrytëzimin e mjeteve nga Programi IPARD 2014-2020 për masat në vijim:

1. Investime në mjete materiale për bujqësi

2. Investime në mjete finansiare për përpunimin e produkteve bujqësore dhe produkteve të peshkut

3. Diversifikim të fermave dhe zhvillim të biznesit

2 Përkrahja finansiare për këtë Thirrje publike është e përbërë prej 75% mjete të siguruara nga Instrumenti për ndihmë parahyrëse për zhvillim rural të Unionit European (IPARD), në përputhje me Marrëveshjen finansiare shumëvjeçare 2014-2020 dhe 25% mjete të siguruara nga Buxheti i Republikës së Maqedonisë.

3 **Mjete finansiare për kërkesë individuale** jepen si përkrahje finansiare e pakthyeshme (grant) në vlerë prej:

3.1 60% nga vlera e shpenzimeve të përgjithshme të pranueshme për ko-finansim të investimeve për masën “Investime në mjete materiale për bujqësi”. Përqindja rritet deri 65% për investime në bujqësi të propozuara nga bujqit e rinj (persona fizik të moshës prej 18 deri 40 vjet në ditën e dorëzimit të kërkesës për shfrytëzimin e mjeteve finansiare) dhe 70% për investime në bujqësi në zonat malore.

3.2 50% nga vlera e shpenzimeve të përgjithshme të pranueshme për masën “ Investime në mjete materiale për përpunimin e produkteve bujqësore dhe produkteve të peshkut”.

3.3 65% nga vlera e shpenzimeve të përgjithshme të pranueshme të investimeve për masën “Diversifikim të fermave dhe zhvillim të biznesit”.

4 Afati i fundit për dorëzimin e kërkesave është 23 qershor viti 2017.

5 Marrja e formularëve dhe udhëzimet:

Formularët e nevojshëm për “Kërkesën për shfrytëzimin e mjeteve finansiare nga Programi IPARD 2014-2020” si dhe “Udhëzuesin për shfrytëzimin e mjeteve finansiare nga Programi IPARD 2007-2013” të cilët përfshijnë të gjitha informatat për kriteriumet, kushtet për pranueshmëri të projekteve dhe kushtet për finansim dhe informata tjera të cilat janë të nevojshme për përgatitjen e kërkesës për shfrytëzimin e mjeteve nga Programi IPARD 2014-2020, Udhëzues për përgatitjen e Planit Afarist, Udhëzues për dhënien e dokumentacionit të nevojshëm nga institucionet kompetente dhe informacione të tjera të dobishme në versionin elektronik mund të meren nga web-adresa e Agjensionit: www.ipardpa.gov.mk.

Formularët e shtypura të kërkesës për shfrytëzimin e mjeteve nga Programi IPARD 2014-2020 mund të merren drejtpërdrejt në Agjension në adresën:

Agjensioni për përkrahje finansiare në bujqësi dhe zhvillim rural

bul. 3 - ta Makedonska Brigada nr 20. (ndërtesa Makedonija Tabak, blloku C), 1000 Shkup

dhe në qendrat më të afërta rajonale të Agjensionit për nxitje të zhvillimit në bujqësi çdo ditë pune prej orës 8:30 deri më 16:30. (Lista e qendrave rajonale apo njësisive punuese të Agjensionit për nxitje të zhvillimit në bujqësi me të dhëna për kontakt është e shpallur në web-adresën www.ipardpa.gov.mk).

6 Mënyra e paraqitjes së kërkesës:

Kërkuesi duhet të plotësojë dhe të dorëzojë Kërkesë për shfrytëzim të mjeteve nga Programi IPARD 2014-2020 për masë individuale, Plan Afarist të përgatitur sipas Udhëzimit për përgatitjen e Planit Afarist

ose Propozim projekt teknik dhe dokumente bashkëngjitur siç është e përmendur në Kërkesën për shfrytëzimin e mjeteve në Thirrjen Publike.

Kërkesa e plotësuar për shfrytëzimin e mjeteve nga Programi IPARD 2014-2020 së bashku me Planin Afarist/ Propozim projektin teknik dhe dokumentet e përgjithshëm të nevojshëm dorëzohen në zarf të mbyllur me shenjë në pjesën e përparme të zarfit në këndin e majtë të epërm “MOS E HAP” për Thirrjen Publike 01/2017 dhe shënimin e shifrës së masës për të cilën dërgohet kërkesa. Kërkesa mund të dërgohet me postë si dërgesë e rekomanduar ose personalisht në arkivin e Agjencionit.

Vërejtje:

Për shkak të kontrollit në teren nga ana e Agjensisë, kërkuesi duhet të ketë me vete kopje të dokumenteve të kompletuar të dorëzuar në Agjencion.

Informata më të hollësishme në kontakt tel. (02) 3097-460 ose në kontakt e-mail adresën: ipardpa.info@ipardpa.gov.mk dhe në web-faqen: www.ipardpa.gov.mk.

PJESA II

INVESTIME NË MJETE MATERIALE PËR EKONOMITË BUJQËSORE

1. Përkrahja financiare për masën “Investime në mjete materiale për ekonomitë bujqësore” i dedikohet prodhimitarisë bujqësore për sketorët prioritar: kopshtari, blegtori, përpunim dhe marketing të drejtpërdrejtë të prodhimitarisë bujqësore personale të fermës, prodhimtari të energjisë nga burimet e rinovueshme për shpenzim personal

2. Lloji i investimit

Kopshtari: (1) drithëra, (2) kultura industriale, (3) perime (përfshirë patatet), (4) kultura shumëvjeçare (pemishte, përfshirë rrushin e tryezës, ulli, drunj mjalti (për prodhimin e mjaltit), (5) vreshta;

b. Blegtori: (1) gjedha (për prodhimin e qumështit dhe për majmëri), (2) derra (për riprodhim dhe majmëri), (3) dele dhe dhi (për prodhimin e qumështit dhe për majmëri), (4) shpezë (për prodhimin e mishit – brojlerë dhe pula për vezë;

c. Përpunim dhe marketing të drejtpërdrejtë të prodhimitarisë bujqësore personale të fermës (marketingu i drejtpërdrejtë ka të bëjë me aktivitete të lidhura me prodhimet bujqësore, përgatitje, shitje të drejtpërdrejtë dhe aktivitete tjera marketingu të fermës, përfshirë edhe produktet e përpunuara të fermës): (1) qumësht dhe produkte qumështi, (2) mish dhe produkte mishi; (3) pemë dhe perime, përfshirë patatet, kërpudhat dhe kulturat leguminoze; (4) drithërat, produktet e mullirit dhe produktet e niseshtes; (5) vajra bimore dhe shtazore dhe yndyrëra; (6) musht rrushi, lëng rrushi, verë dhe uthull.

ç. Prodhim të energjisë nga burime të rinovueshme për shpenzim personal, nëpërmjet përpunimit të produkteve bimore dhe shtazore nga biomasa primare dhe sekondare (përveç biomasës së produkteve të peshkut) për prodhimin e gasit bio dhe/apo lëndëve djegëse bio, shfrytëzimit të energjisë diellore, mullirit me erë, energjisë gjeotermale etj.

3. Shfrytëzues

Kërkues për shfrytëzim të mjeteve në këtë masë mund të jenë ekonomitë bujqësore, të cilat janë të regjistruara në Regjistrin e vetëm të ekonomive bujqësore (RVEB) në MBPEU në përputhje me Ligjin për bujqësi dhe zhvillim rural (“Gazeta zyrtare e RM” nr. 49/10).

Ekonomia bujqësore mund të jetë e regjistruar në RVEB si ekonomi bujqësore familjare e përfaqësuar nga një person fizik apo bujk individual apo si ekonomi bujqësore e përfaqësuar nga një person juridik.

Personi fizik është anëtar i një ekonomie bujqësore familjare i cili është i autorizuar ta përfaqësojë Ekonominë bujqësore para institucioneve, nga anëtarët e familjes së ekonomisë bujqësore familjare. Përfaqësuesi i ekonomisë bujqësore familjare dhe anëtarët të cilët jetojnë në adresën e njëjtë e cila është seli e Ekonomisë bujqësore pamvarsisht vendit të pronës bujqësore.

Bujk individual është personi fizik i cili merret me veprimtari bujqësore për llogari personale dhe është pronar i pronës bujqësore apo ka të drejtë të shfrytëzojë pronë bujqësore të fituar nëpërmjet marrëveshjes për shfrytëzim me pronarin dhe është i regjistruar në RVEB dhe në Regjistrin e Prodhuesve bujqësor në kuadër të MBPEU si bujk individual apo në Fondin Pensional.

Personat juridik mund të fitojnë përkrahje nëse në kapitalin e tyre total kanë një pjesëmarrje nga shteti në lartësi jo më të madhe se 25% për tërë periudhën e projektit dhe në periudhë prej së paku 5 vite nga përfundimi i aktivitetit investues të finansuar nga ky program janë të pranueshëm shfrytëzues potencial për shfrytëzimin e mjeteve të Programit IPARD 2014-2020.

Kooperativa e cila është e regjistruar në Regjistrin qëndror sipas Ligjit për kooperativa e cila kryesisht kryen aktivitete bujqësore, përpunim të produkteve bujqësore dhe/apo shërbime të cilat drejtpërdrejt janë të lidhura me aktivitetet bujqësore.

Kooperativa bujqësore e cila kryesisht merret me prodhimtari bujqësore duhet të jetë në përputhje me Ligjin për kooperativa bujqësore dhe të jetë e regjistruar në Regjistrin e kooperativave bujqësore pranë MBPEU.

4. Kriteret e përgjithshme

Të gjithë kërkuesit të cilët aplikojnë për investime në lidhje me kopshtarinë në periudhën e paraqitjes së aplikacionit duhet të tregojnë ekzistimin e një prone bujqësore të punueshme të regjistruar në Sistemin për identifikim të ngastrave (SIN) me madhësi minimale në varësi të aktivitetit të kopshtarisë e cila është objekt i investimit siç është përcaktuar në tabelën më poshtë.

Të gjithë aplikuesit të cilët aplikojnë për investime lidhur me prodhimtarinë blegtorale duhet të tregojnë ekzistimin e një numri minimal të njësisve blegtorale (NjB) të regjistruara në Regjistrin e identifikimit të kafshëve të udhëhequr nga Agjensioni për ushqim dhe veterinë (AUV) para se të paraqesin aplikacionin e pagesës me madhësi minimale në varësi të aktivitetit të prodhimtarisë blegtorale e cila është objekt i investimit siç është përcaktuar në tabelën më poshtë.

KAPACITETET PRODHUESE TË APLIKUESIT

SEKTORI PRIOTIRAR		Kapaciteti prodhues minimal i regjistruar në SIN/AUV
KOPSHTARIA	Bimë (kultura) shumëvjeçare dhe sera	0,3 ha

	Prodhimi i perimeve në hapësirë	0,5 ha
PRODHIMTARIA BLEGTORALE	Gjedha	5 NjB
	Dele dhe/apo dhi	1,5 NjB
	Derra	8 NjB
	Shpezë (me përjashtim të rosave, patateve, gjeldetit, thëllënzave, struçëve, emu dhe pulave afrikane)	10 (NjB)

Të gjithë aplikuesit të cilët parashohin furnizim me makineri bujqësore duhet të tregojnë minimum 1 h tokë bujqësore të punueshme nën kopshtari të regjistruar në SIN.

Aplikuesi, përveç kapaciteteve prodhuese të regjistruara në SIN duhet të dëshmojë edhe pronësi apo të drejtë të shfrytëzimit të tokës duke paraqitur fletpronësi bashkëngjitur me aplikacionin si dhe marrëveshje për qera për një periudhë jo më të shkurtër se 7 gjegejesisht 10 vite në rast të ndërtimit/rikonstruimit të objektit, ripërtrirjes së kulturave shumëvjeçare dhe sistemit për ujitje, nga dita e paraqitjes së aplikacionit. Marrëveshje për qera, kohëzgjatja dhe sipërfaqja e cila është objekt i marrëveshjes duhet të jetë i shënuar në fletpronësi, në mënyrë obligative.

Shfrytëzuesit janë të obliguar t'i evidentojnë të gjitha ndryshimet e kapaciteteve prodhuese në Regjistrin e fermave dhe në Sistemin e identifikimit të ngastrave dhe/apo Regjistrin e identifikimit të shtazëve posaçërisht ato të cilat janë rezultat i realizimit të investimit para paraqitjes së aplikacionit definitiv për pagesë.

Personi përgjegjës/mbajtësi i ekonomisë bujqësore:

- Duhet të ketë të mbaruar minimum arsim të mesëm apo arsim të lartë nëpërmjet diplomës/certifikatës apo
- Duhet të dëshmojë minimum 3 vite përvojë pune në lëmin e prodhimtarisë bujqësore, përpunim apo shërbime të lidhura me bujqësinë (të dëshmuar nëpërmjet dëshmisë për përvojë pune profesionale apo nëpërmjet dëshmisë si shfrytëzues i programeve kombëtare për përkrahje në bujqësi dhe zhvillim rural apo dëshmi tjera të shkruara të pranueshme).
- Dëshmi se së paku njëri nga menaxhuesit e personit juridik, të cilët e përfaqësojnë personin juridik në procedurën para Agjensionit, është në marrëdhënie të rregullt pune tek personi juridik i cili paraqitet si aplikues i përkrahjes financiare apo është i angazhuar me marrëveshje në periudhë jo më të shkurtër se periudha e marrëveshjes për përkrahje financiare të nënshkruar me Agjentinë.

5. Kritere specifike sipas llojeve të investimeve

Investimi për furnizim me makineri/traktor: furnizimi me makineri bujqësore – traktor duhet të jetë në përputhje me parametrat e përcaktuar në tabelën “Fuqia maksimale e pranueshme e traktorëve”, gjegejesisht fuqia e traktorit të propozuar për furnizim të korespondojë me kapacitetet e regjistruara prodhuese të ekonomisë bujqësore.

Fuqia maksimale e pranueshme e traktorëve

Fuqia maksimale e pranueshme për traktorët në një sektor prioritar dhe madhësia/kapaciteti		
Lloji i prodhimitarisë bimore	Madhësia (ha)	Fuqia maksimale (kW)
Prodhimtari e përzier bujqësore përfshirë livadhet dhe kullosat	1-2	60
Prodhimtaria e pemëve dhe perimeve	2-10	60
	10-50	80
	Mbi 50	100
Perime	2-10	40
	10-50	60
	Mbi 50	80
Drithëra, foragjere dhe kulturat industriale	2-10	60
	10-50	80
	Mbi 50	100
Lloji i prodhimitarisë blegtorale	Madhësia e NjB (Njesisë Blegtorale)	Fuqia maksimale (kW)
Gjedhe për majmëri dhe gjedha për qumësht	5-20	60
	20-50	80
	Mbi 50	100
Majmëri të derrave	8-50	60
	50-500	80
	Mbi 500	100
Dhi/dele	1,5-15	60
	15-500	80
	Mbi 500	100
Shpezë	10-560	60
	560-1400	70

	Mbi 1400	100
--	-----------------	------------

Në rast se aplikuesi ka shfrytëzuar përkrahje të BE për traktor në të kaluarën, nuk mund të aplikojë përsëri për investim në traktor në kuadër të Programit IPARD 2014-2020. Ky kufizim nuk ka të bëjë me kooperativat bujqësore.

6. Lartësia e finansimit

Vlera minimale e shpenzimeve të pranueshme është 3 000 euro në kundërvlerë të denarit

Vlera maksimale e përkrahjes financiare për një shfrytëzues nuk mund të tejkalojë 1.500.000 euro në kundërvlerë të denarit nga shpenzimet e përgjithshme të pranueshme

Shuma maksimale e përkrahjes financiare për një shfrytëzues nuk mund të tejkalojë shumën e lartëshënuar ndërsa të njëjtën mund ta shfrytëzojë edhe në një thirrje publike gjegjësisht me një investim në kuadër të periudhës finansuese 2014-2020.

Përkrahja e përgjithshme financiare (75% nga fondet BE + 25% ko-finansim kombëtar) i cili paguhet si ko-finansim i investimit në kuadër të kësaj mase **arrin 60%** të shpenzimeve të përgjithshme të pranueshme të investimit.

Kjo përqindje e ko-finansimit do të rritet deri:

- 65% për investime në ekonomitë bujqësore të propzuara nga ana e bujqëve të rinj (persona fizik të moshës 18 deri 40 vjeçare në ditën e paraqitjes së aplikacionit për përkrahje financiare);
- 70% për investime në ekonomi bujqësore në zonat malore

Prëqindja e ko-finansimit do të rritet për 10 pikë përqindjeje për pjesën e investimit i cili ka të bëjë me:

- Investim në sisteme të ruajtjes dhe menaxhimit të plehut (shembull: magazinim, trajtim, përdorim i mëtejshëm dhe të ngjajshme);
- Investim për përmirësimin e efikasitetit të përdorimit të plehrave të azotit (shembull: përdorim i reduktuar, pajisje për përdorim preciz të plehrave dhe të ngjajshme);
- Investim në objekte/pajisje qëllimi i të cilave është përmirësimi i efikasitetit energjetik (shembull: përdorimi i materialeve ndërtimore të cilat zvogëlojnë humbjen e nxehtësisë);
- Investim në objekte/pajisje për prodhimin e energjisë bio në rast të përpunimit të produkteve (lënëdës së parë) të përfshira në Aneksin I të Marrëveshjes me BE (përpunimi i bio masës primare dhe sekondare shtazore dhe bimore)
- Investim në objekte/pajisje për prodhimin e energjisë nga burime tjera të rinovueshme të energjisë që t'i përmbushin nevojat personale për energji të ekonomisë bujqësore;
- Investim në objekte/pajisje për trajtimin e ujrave/ujrave të zeza.

Vërejtje: Zmadhimi i përqindjes së përkrahjes financiare për 10 pikë përqindjeje ka të bëjë vetëm me pjesën e investimit për të cilin bëhet zmadhimi i përkrahjes, dhe jo për tërë investimin e propozuar.

7. Lista e dokumenteve të nevojshme

Dokumentet e poshtëshënuara të cilët dorëzohen bashkëngjitur me aplikimin për shfrytëzim të mjeteve nga Propgrami IPARD (2014-2020) duhet të jenë origjinale apo kopje të noterizuara, nëse nuk është përcaktuar ndryshe përveç dokumentit. Nëse dokumentet janë në gjuhë të huaj, të njëjtit duhet të kenë bashkëngjitur përkthimin në gjuhën maqedone të certifikuar nga një përkthyes i autorizuar. Dokumentet të cilat lëshohen në bazë të regjistrave publik apo sistemit të themeluar të evidencës nuk duhet të jenë më të vjetër se tre muaj duke llogaritur nga dita e shpalljes së thirrjes publike, me përjashtim të dokumenteve të cilët vërtetojnë përmbushjen e obligimeve për taksa dhe kontribute të paguara i cili nuk duhet të jetë më i vjetër se një muaj duke llogaritur nga dita e shpalljes së thirrjes publike.

1. KËRKESË PËR MASËN INVESTIM NË MJETE MATERIALE TË EKONOMIVE BUJQËSORE

2. KOPJE TË LETËRNJOFTIMIT APO PASAPORTËS

3. DËSHMI PËR ARSIMIM TË MBARUAR (SË PAKU ARSIM TË MESËM) TË KËRKUESIT-PERSON FIZIK APO PERSONIT PËRGJEGJËS TË PERSONIT JURIDIK APO KOOPERATIVËS BUJQËSORE, APO DËSHMI PËR NJË TRAJNIM QË KA REALIZUAR NË LIDHJE ME INVESTIMIN, APO DEKLARATË TË NËNSHKRUAR SE KËRKUESI PAJTOHET QË TË MARRË PJESË NË NJË TRAJNIM PROFESIONAL NË LIDHJE ME INVESTIMIN

4. DËSHMI NGA KËRKUESI SE NË FUND TË INVESTIMIT DO TË REGJISTROHET PËR KRYERJE TË VEPRIMTARISË SHITESË (PËR PËRPUNIMIN E PRODUKTEVE BUJQËSORE) TË EKONOMISË BUJQËSORE (Ky dokument është obligativ në rastet kur kërkuesi është ekonomi bujqësore e cila propozon investime të reja gjegjësisht kërkuesi nuk është i regjistruar të kryej veprimtari shtresë në momentin e paraqitjes së kërkesës).

5. DËSHMI NGA KËRKUESI SE NË FUND TË INVESTIMIT DO TË REGJISTROHET NË REGJISTRIN E EKONOMIVE BUJQËSORE (Ky dokument dorëzohet në rastet kur kërkuesi propozon investim të ri në prodhimtarinë e blegtorisë)

6. DEKLARATË NGA KËRKUESI SE ËSHTË I NJOFTUAR ME KUSHTET E PARAPARA NË LISTËN E KUSHTEVE TË POSAÇME MINIMALE PËR NJË PRAKTIKË TË MIRË BUJQËSORE DHE MBROJTJE TË AMBIENTIT JETËSOR TË PUBLIKUARA NË “GAZETËN ZYRTARE TË REPUBLIKËS SË MAQEDONISË NR. 178/2015” DHE SE TË NJËJTAT DO T’I RESPEKTOJË DHE DO T’I ZBATOJË NË TËRË EKONOMINË BUJQËSORE PARA SE TË PARAQESË KËRKESËN PËR PAGESË.

7. REGJISTËR AKSIONAR DHE LETËR BASHKËNGJITUR (Këto dokumente janë obligative në rastet kur kërkuesi është shoqëri aksionare dhe në rastete kur nuk ekzistojnë të dhëna për kompaninë në web faqen e Depozituesit qendror të letrave me vlerë të Republikës së Maqedonisë).

8. DËSHMI SE SË PAKU NJË PERSON PËRGJEGJËS ËSHTË NË MARDHËNIE TË RREGULLT PUNE NË SUBJEKTIN JURIDIK APO DËSHMI SE SË PAKU NJË PERSON PËRGJEGJËS ËSHTË I ANGAZHUAR ME MARRËVESHJE, APO DËSHMI SE SË PAKU NJË PERSON PËRGJEGJËS ËSHTË I PUNËSUAR PËRKOHËSISHT NË SUBJEKTIN JURIDIK (Vërtetimi është obligativ në rast se kërkuesi ka të regjistruar firmë gjegjësisht në rast të investimit të ri, njëri nga këto dokumente duhet të dorëzohet deri në fund të investimit)

9. DËSHMI PËR DETYRIME TË SHLYERA NË LIDHJE ME TAKSAT, SIGURIMIN PENSIONAL DHE INVALIDOR DHE SIGURIMIN SHËNDETËSOR.

10. DËSHMI SE KËRKUESI NUK ËSHTË NË PROCEDURË TË FALIMENTIMIT DHE LIKUIDIMIT (Ky dokument është obligativ vetëm për kërkuesit të cilët janë subjekte juridike).

11. DËSHMI SE KUNDËR KËRKUESIT NUK ËSHTË SHQIPTUAR MASË NDALESË PËR KRYERJE TË VEPRIMTARISË APO PROFESIONIT (Ky dokument është obligativ vetëm për kërkuesit të cilët janë subjekte juridike).

12. VENDIM PËR ELABORAT TË MIRATUAR PËR MBROJTJEN E AMBIEBTIT JETËSOR, APO VENDIM PËR ELABORAT TË MIRATUAR PËR MBROJTJEN E AMBIEBTIT JETËSOR ME PLAN AKSIONAL TË MIRATUAR, APO A APO B LEJE TË INTEGRUAR EKOLOGJIKE, APO KËRKESË TË MIRATUAR PËR DHËNIE TË LEJES SË INTEGRUAR EKOLOGJIKE A APO B, APO KËRKESË PËR DHËNIE TË VENDIMIT PËR ELABORAT TË MIRATUAR PËR MBROJTJEN E AMBIEBTIT JETËSOR (Dokumenti ka të bëjë me kërkuesit të cilët kanë të regjistruar apo propozojnë investime në prodhimtarinë e qumështit, mishit, vezëve, aktiviteteve pas vjeljes dhe përpunimit të produkteve bujqësore të ekonomisë bujqësore).

1. DOKUMENTE TË PRONËSISË DHE/APO TË DREJTË SHFRYTËZIMI TË TOKËS/OBJEKTIT TË CILËT JANË LËNDË E INVESTIMIT

- 1. FLETPRONËSI TË OBJEKTIT, DHE/APO TË TOKËS**
- 2. MARRËVESHJE PËR QERA PËR OBJEKTIN, DHE/APO PËR TOKËN**
- 3. MARRËVESHJE PËR KONCESION TË TOKËS**

Marrëveshja është valide në periudhë prej së paku 7 viteve duke llogaritur nga dita e dorëzimit të kërkesës për përkrahje financiare në rast të furnizimit me makineri/pajisje;

Marrëveshja është valide në periudhë prej së paku 10 viteve duke llogaritur nga dita e dorëzimit të kërkesës për përkrahje financiare në rast të ndërtimit/rikonstruimit/përmirësimit të sistemit për ujitje/ripërtëritje të kulturave shumëvjeçare;

13. DËSHMI PËR DETYRIME TË SHLYERA ME RREGULL NË LIDHJE ME MARRËVESHJEN PËR KREDI (Dokumenti dorëzohet ekluzivisht në rast se Banka e ka nën zotim pronën e cila është objekt i investimit)

DOKUMENTE PRË PUNË NËDËRTIMORE

(DOKUMENTET E POSHTËSHËNUARA JANË TË NEVOJSHME TË JENË NË PAJTUESHMËRI ME LIGJIN PËR NDËRTIM)

14. LEJE NDËRTIMI APO DEKLARATË NGA KËRKUESI SE LEJA RELEVANTE DO TË DORËZOHET DERI NË ARRITJEN E MARRËVESHJES (Deklaratë dorëzohet në rastet kur kërkuesi nuk është në gjendje të marrë leje deri në ditën e dorëzimit të kërkesës për shfrytëzim të mjeteve).

APO DEKLARATË NGA INSTITUCIONI KOMPETENT SE PËR INVESTIMIN E PROPOZUAR NUK ËSHTË E NEVOJSHME LEJE.

15. KOPJE TË VIZATIMEVE THEMELORE TEKNIKE DHE FATURËN E SASIVE TË REVIDUAR TË DOKUMENTEVE TEKNIKE (OSE NË FORMË ELEKTRONIKE – CD) (Dokumentet e projektit të cilët dorëzohen në Agjensionin për përkrahje financiare në bujqësi dhe zhvillim rural, në tërësi duhet të përputhen me dokumentet e projektit (numrin teknik) e cila dorëzohet/do të dorëzohet tek organi kompetent si pjesë e kërkesës së dorëzuar për marrje të lejes për ndërtim).

(Dokumenti duhet të jetë i verifikuar nga ana e personave të autorizuar për përpilimin e dokumenteve teknike dhe revizionist)

16. SITUATË/GJENDJE E PËRKOSSHME PËR TË GJITHA PUNËT E MBARUARA NDËRTIMORE (Situatë/gjendje e përkohshme dorëzohet në rastet kur kërkuesi ka ndërtuar një pjesë të caktuar të objektit i cili është objekt i investimit, gjegjësisht punët e kryera ndërtimore duhet të jenë në përputhje me dokumentacionin e fundit teknik të aprovuar).

17. DOKUMENTE ME TË CILËT DËSHMOHET AFTËSIA/QËNDRUESHMËRIA EKONOMIKE

1. PLAN AFARIST

(Plani afarist është një dokument obligativ nëse vlera e përgjithshme e investimit të planifikuar është më e madhe se 50.000 euro në kundërvlerë të denarit pa TVSH).

2. PROPOZIM PROJEKT TEKNIK

(Propozim projekti teknik është një dokument obligativ nëse vlera e përgjithshme e investimit të planifikuar është më e vogël se 50.000 euro në kundërvlerë të denarit pa TVSH).

18. OFERTA PËR PUNË/PAJISJE NËDRTIMORE

1. OFERTË NGA FURNIZUESI PËR ÇDO SHKALLË/GRUPË TË SHKALLËVE, ME VLERË MË TË VOGËL SE 10.000 EURO NË KUNDËRVLERË TË DENARIT

2. TRE OFERTA NAG FURNIZUES TË NDRYSHËM, PËR SHKALLË/GRUPË TË SHKALLËVE ME VLERË MË TË MADHE SE 10.000 EURO NË KUNDËRVLERË TË DENARIT

3. DEKLARATË NGA FURNIZUESI/T PËR VENDIN E ORIGJINËS

Deklarata është një dokument obligativ nëse oferta është me vlerë më të lartë se 100.000 euro.

(Deklarata është një dokument obligativ në rastet kur oferta nuk ka të dhëna për vendin e origjinës së prodhuesit për makinerinë/pajisjet).

19. DËSHMI PËR NJË STRUKTURË PRONËSORE PËR TË GJITHË FURNIZUESIT E HUAJ

20. REGJISTËR AKSIONAR NË FORMË ELEKTRONIKE – CD/FORMË TË LETRËS, DHE/APO LETËR BASHKËNGJITUR

(Dokumentet e lartëpërmendura janë obligative në rastet kur furnizuesi është shoqëri aksionare).

21. DEKLARATË NGA KËRKUESI, ME SHPJEGIM PËR ARSYET PËR ZGJEDHJEN E OFERTËS KONKRETE

(Dokumenti është obligativ në rastet kur furnizimi është me vlerë më të lartë se 10.000 euro në kundërvlerë të denarit për shkallë/grupë të shkallëve, nëse mallrat/shërbimet e zgjedhura nuk kanë vlerë më të ulët).

22. OFERTË/FATURË/MARRËVESHJE PËR SHPENZIME TË PËRGJITHSHME (për furnizime me vlerë më të lartë se 10.000 euro në kundërvlerë të denarit duhet të paraqesë 3 oferta për çdo artikull)

(SHPENZIMET E PËRGJITHSHME PRANOHEN NËSE TË NJËJTAT KANË NODHUR PAS DATËS 01.01.2014)

Agjensioni ka të drejtën të kërkojë dokumente shtesë me qëllim që të dëshmohet përmbushja e kriterëve të Programit IPARD për shfrytëzimin e përkrahjes financiare. Poashtu Agjensia ka të drejtë të kërkojë dokumente shtesë për Kërkuuesin nga Institucione tjera me të cilët dëshmohet përmbushja e kriterëve përkatëse të Programit.

Pjesa III

INVESTIME NË MJETE MATERIALE PËR PËRPUNIMIN E PRODUKTEVE BUJQËSORE DHE TË PESHKUT

1. Sektorë të praneshëm

- Qumësht dhe produkte qumështi;
- Mish dhe produkte të mishit (duke përfshirë vezët dhe shpezët);
- Pemë dhe perime (duke përfshirë patatet, kërpudhat dhe kulturat leguminoze);
- Drithëra, produkte të mullirit dhe niseshte;
- Produkte bimore dhe vajra dhe yndyrë shtazore;
- Mushti, vera dhe uthulla; dhe
- Prodhimi i energjisë nëpërmjet reparteve për përpunim dhe produkte të shtazëve nga biomasa primare dhe sekondare, me përjashtim të biomasës së produkteve të peshkut.

2. Shfrytëzues

- Prsona juridik të cilët janë të regjistruar në Regjistrin qendror në përputhje me Ligjin për shoqëri tregtare, dhe të cilët punësojnë më pak se 250 persona dhe kanë qarkullim vjetor i cili nuk kalon 50 milion euro, dhe/apo bilans vjetor të gjendjes i cili nuk tejkalon 43 milion euro që i përgjigjet definicionit të tanishëm për ndërmarrje të vogla dhe të mesme (NVM) e cila përfshihet në Rekomandimin e Komisionit 2003/361 / EZ.

- Ndërmarrje të cilat janë përfshirë me definicionin për NVM, por që punësojnë më pak se 750 persona dhe të cilët kanë qarkullim vjetor i cili nuk tejkalon 200 milion euro, poashtu mund të jenë të pranueshme, por, në këtë rast përkrahja mund të jepet për investime të dedikuara që ta bëjnë tërë ndërmarrjen në përputhje me standardet relevante të BE. Vlerësim të madhësisë së shfrytëzuesve bëhet nga ana e Agjensisë.

- Kooperativa të cilat janë të regjistruara në Regjistrin qendror në përputhje me Ligjin për kooperativa dhe kryesisht merren me veprimtari bujqësore, përpunim të produkteve bujqësore dhe/apo shërbime drejtpërdrejt të lidhura me aktivitetet bujqësore.

- Personat juridik të ranguar si ndërmarrje mikro nuk janë të pranueshme për përkrahje në kuadër të kësaj mase.

- Ndërmarrjet e sapoformuara do të vlerësohen në bazë të madhësisë së pritshme siç është propozuar në planin e biznesit.

- Të dhënat e nevojshme në bazë të të cilave mund të konstatohet madhësia e subjektit juridik merren nga dokumenti "PËRMBLEDHJE E TË DHËNAVE NGA LLOGARIA VJETORE PËR VITIN E

KALUAR” të lëshuar nga Regjistri Qëndror i Republikës së Maqedonisë. Dokument valid nëpërmjet të cilit mund të konstatohet madhësia e subjektit juridik për shpalljen përkatëse është ai i cili ka të bëjë me vitin kalendarik paraparak.

3. Kriteret e pranueshmërisë

– Kërkuesi duhet të paraqesë “Kërkesë për shfrytëzim të mjeteve nga Programi IPARD II” bashkëngjitur me të gjithë dokumentet e nevojshme

– Kërkuesi duhet të jetë i regjistruar në Regjistrin Qëndror si person juridik apo kooperativë bujqësore

– Kërkuesi, kooperativa bujqësore duhet të jetë e regjistruar në Regjistrin e kooperativave bujqësore të Ministrisë së bujqësisë, pylltarisë dhe ekonomisë së ujrave

– Të gjithë shfrytëzuesit duhet të jenë të regjistruar në Agjesionin për ushqim dhe veterinë si operatorë me ushqim apo të evidentuar për shkak të ndryshimeve të shkaktuara nga investimet në fjalë në përputhje me Ligjin për siguri të ushqimit në fund të investimit.

– Investimet duhet të realizohen në pronën e cila është në pronësi të kërkuesit. Në rast të projekteve investuese të cilët realizohen në pronë e cila nuk është në pronësi të kërkuesit, duhet të paraqitet një marrëveshje apo dokument tjetër bashkëngjitur që të dëshmojë të drejtën e shfrytëzimit të pronës që ka të bëjë me investimin në një periudhë prej së paku 10 vite nga dita e paraqitjes së kërkesës për përkrahje.

– Kërkuesi i përkrahjes financiare duhet të jetë i regjistruar në sistemin kombëtar për TVSH në përputhje me Ligjin për tatim të vlerës së shtuar.

– Para se të paraqitet kërkesa për pagesë, së paku një person përgjegjës i subjektit juridik i cili përfaqëson ndërmarrjen është në marrëdhënie të përhershme pune me subjektin juridik apo është i angazhuar me marrëveshje në kohëzgjatje jo më të shkurtë se kohëzgjatja e marrëveshjes për dhënie të përkrahjes financiare në kuadër të këtij Programi.

– Shfrytëzuesi është i obliguar t’i përmbushë standardet relevante të BE të lidhura me realizimin e investimit para se të paraqesë kërkesën për pagesë.

– Kërkuesi i cili propozon investim në sektorin e verës, duhet të jetë i regjistruar në regjistrin e prodhuesve të verës para paraqitjes së kërkesës për pagesë.

– Kërkuesi i cili propozon investim në një qendër për grumbullim dhe shpërndarje të pemëve dhe perimeve, drithërave dhe qumështit duhet të jetë i regjistruar në regjistrin e grumbulluesve para se të paraqesë kërkesën për pagesë.

– Ndihmë mund t’i jepet shfrytëzuesve projektet investuese të të cilëve mundësojnë qëndrueshmëri financiare/ekonomike. Qëndrueshmëria ekonomike financiare do të vlerësohet në bazë të palnit të biznesit. Kërkuesi duhet ta paraqesë mundësinë për kontinuitet të punës në një afat prej së paku pesë viteve nga realizimi i investimit. Në bazë të indikatorëve ekonomik në vijim do të vlerësohet projekti investues:

- Shkallë të modifikuar interne të rentabilitetit e cila duhet të jetë më e madhe se 0,
- Neto vlera e tanishme e cila duhet të jetë më e madhe se 0, dhe
- Periudha e kthimit të investimit e cila duhet të jetë më e vogël se 10 vite

4. Lartësia e finansimit

Përkrahja e përgjithshme finansare (75% fonde të BE + 25% bashkëfinansim kombëtar) nuk do ta kalojnë kufirin e sipërm prej **50% nga shpenzimet e përgjithshme të investimit.**

Përkrahja financiare për masën Investim në mjete materiale për përpunimin e produkteve bujqësore dhe të peshkut mund të rritet për 10% për:

- Investim në ndërtesa/pajisje qëllimi i të cilave është përmirësimi i efikasitetit energjetik (p.sh. përdorimi i materialit ndërtimor i cili e zvogëlon humbjen e energjisë);
- Investim në ndërtesa/pajisje për prodhimin e bioenergjisë në rast të përpunimit të produkteve (lëndë e parë) i cili është i mbuluar me Aneksin 1 të Marrëveshjes me BE (përpunimi i biomasës primare dhe sekundare të shtazëve dhe bimëve);
- Investim në ndërtesa/pajisje për prodhimin e energjisë nga burime tjera të rinovueshme të energjisë që të prodhohen sasi të njëjta me nevojat personale për energji elektrike për ndërmarrjet e përpunimit;
- Investim në ndërtesa/pajisje për trajtimin e ujit/ujit të zi.

Që të fitoni përkrahje në kuadër të kësaj mase, shpenzimet e përgjithshme të pranueshme për projektin e propozuar investues duhet të arrijnë së paku 10.000 euro në kundërvlerë të denarit.

Vlera më e lartë e shpenzimeve të pranueshme për shfrytëzues për tërë periudhën e zbatimit të këtij programi arrin 4.500.000 euro në kundërvlerë të denarit.

5. Lista e dokumenteve të nevojshme

Dokumentet e poshtëshënuara të cilët paraqiten bashkëngjitur me kërkesën për shfrytëzim të mjeteve nga Programi IPARD (2014-2020) duhet të jenë origjinale apo kopje të noterizuara, nëse nuk është përcaktuar ndryshe përkaj dokumentit. Nëse dokumentet janë në gjuhë të huaj, të njëjtit duhet të kenë bashkëngjitur përkthimin në gjuhën maqedone të certifikuar nga një përkthyes i autorizuar. Dokumentet të cilat lëshohen në bazë të regjistrave publik apo sistemit të themeluar të evidencës nuk duhet të jenë më të vjetër se tre muaj duke llogaritur nga dita e shpalljes së thirrjes publike, me përjashtim të dokumenteve të cilët vërtetojnë përmbushjen e obligimeve për taksa dhe kontribute të paguara i cili nuk duhet të jetë më i vjetër se një muaj duke llogaritur nga dita e shpalljes së thirrjes publike.

1. KËRKESË PËR MASËN PËR PËRPUNIMIN E PRODUKTEVE BUJQËSORE DHE TË PESHKUT

2. DËSHMI SE KËRKUESI ËSHTË I REGJISTRUAR NË SISTEMIN PËR TVSH

3. VËRTETIM PËR TAKSA DHE KONTRIBUTE TË PAGUARA

4. KOPJE TË LETËRNJOFTIMIT APO PASAPORTËS

5. DËSHMI SE KËRKUESI NUK ËSHTË NË PROCEDURË TË FALIMENTIMIT

6. DËSHMI SE KËRKUESI NUK ËSHTË NË PROCEDURË TË LIKUIDIMIT

7. DËSHMI SE NUK ËSHTË SHQIPTUAR SANKSION KUNDËRVAJTËS NDALESË PËR USHTRIM TË PROFESIONIT, VEPRIMTARISË APO DETYRËS DHE NDALESË E PËRKOHSHME PËR KRYERJE TË NJË VERPIMTARIE TË CAKTUAR

8. DOKUMENTE TË PRONËSISË DHE/APO TË DREJTË SHFRYTËZIMI TË TOKËS/OBJEKTIT TË CILËT JANË OBJEKT I INVESTIMIT

